

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6199
E enjte, 24 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

Osmani: Pas
aktgjyimit të plotë të
Kushtetueses caktohet
data e zgjedhjeve IFAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

2020, VIT I MBRAPSHTË I
KOSOVËS F. 11

Shkruan:
Ismail SYLA



AKTUALE



BE-ja NDIHMOM KOSOVËN
ME 24 MILIONË EURO F. 3

PEZULLOHEN LINJAT AJRORE ME
BRITANINË E MADHE F. 7

PËR 24 ORË EDHE 12 TË VDEKUR
NGA COVIDI NË KOSOVË F. 3

EKONOMI



DUHEN KATËR VJET PËR
T'U RIMËKËMBUR EKONOMIA
E KOSOVËS F. 8

IMPORTI NË MUJIN
NËNTOR KAPI SHIFRËN
305.7 MILIONË EURO F. 9

SPORT

MUNISHI, PAS SHKARKIMIT:
LAMTUMIRË SUHAREKË! F. 12

ENVER HOXHAI, KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR IFAQE 4



Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka marrë besimin e strukturave të kësaj partie për kandidat për kryeministër. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se Hoxhaj është kandidati më i mirë për ta drejtuar qeverinë e ardhshme të Kosovës. Ai ka theksuar se Hoxhaj ka punuar gjatë dhe afër me dy burrështetasit e Kosovës, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. "PDK-ja me kandidatin e saj për kryeministër, Enver Hoxhaj, do të konfirmohet forca më e madhe politike në vend dhe do të dëshmojë edhe një herë si e vetmja që di të qeverisë dhe në qendër të qeverisjes së saj do të jetë qytetari", ka deklaruar Ismaili

RRUGË E GJATË DERI TE ARRITJA E MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË IFAQE 7



Pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shkuarje në zgjedhje të parakohshme, dialogu do të vazhdojë të diskutohet gjatë fushatës zgjedhore dhe do të jetë ndër temat qendrore edhe për qeverinë pasardhëse. Kështu është thënë në diskutimin e tretë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) "Viti i ri, dialogu i vjetër?"

MUSTAFA: LDK-ja PAS ZGJEDHJEVE DO TË DALË EDHE MË E FUQISHME IFAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi paralajmëron se nuk do ta nënshkruajë paketën e ndihmës



Uashington, 23 dhjetor - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka quajtur paketën e ndihmës ekonomike 900 miliardë dollarësh, të miratuar nga Kongresi, një "turp", duke sugjeruar që ai nuk do ta nënshkruajë atë.

Në një video të postuar në "Twitter", Trump nuk tha në mënyrë të qartë se do të vinte veton mbi projektligjin, por u

ankua se ai përmban shumë shpenzime të kota dhe nuk ofron mbështetje të mjaftueshme të drejtpërdrejtë për amerikanët.

Projektligji siguron një pagesë të vetme prej 600 dollarësh për shumicën e amerikanëve, por Trumpi tha se ai po i kërkon Kongresit ta ndryshojë projektligjin dhe "ta rrisë shumën nga 600 në 2 000 ose 4 000 dollarë për një çift". "Unë

jam duke kërkuar që Kongresi t'i heqë gjërat e kota dhe të panevojshme nga ky legjislacion dhe të më dërgojë një projektligji të përshtatshëm", ka deklaruar Trump. Ai, gjithashtu, tha se projektligji nuk ofron mbështetje të mjaftueshme për bizneset e vogla, veçanërisht për restorantet.

Republikanët dhe demokratët kanë negociuar projektligjin që nga muaji korrik.

Erdogani: Shpresojmë për përmirësimin e raporteve me ShBA-në dhe BE-në

ANKARA, 23 DHJETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë të mërkurën se Turqia shpreson "të hapë një faqe të re" në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian dhe se Ankara është subjekt i standardeve të dyfishta edhe nga aleati i NATO-s, Uashingtoni, por edhe nga blloku evropian.

Këtë muaj Uashingtoni vendosi sanksione ndaj Turqisë

për shkak të blerjes së sistemeve të mbrojtjes raketore S-400 nga Rusia dhe BE-ja, po ashtu po përgatit masa ndaj Turqisë për shkak të eksplorimeve për gaz që ka kryer në ujërat e Greqisë dhe Qipros. Megjithatë, vendimi për sanksione ndaj Turqisë nga blloku evropian është shtyrë për në muajin mars. Duke folur para ligjvënësve të partisë turke AK që është në pushtet, Erdogan tha se "agjendat

artificiale" kanë vënë në sprovë marrëdhëniet e Turqisë me ShBA-në dhe BE-në më 2020, por ai tha se shpreson se raportet do të përmirësohen. "Turqia po përballet me standarde të dyfishta edhe për Mesdheun Lindor (v. j. ku Ankara ka kryer eksplorime për gaz) si dhe për sistemin S-400. Ne duam të hapim një faqe të re me ShBA-në dhe BE-në vitin e ardhshëm", ka deklaruar Erdogan.



Grenelli emërohet për të shërbyer në Këshillin Memorial të Holokaustit



UASHINGTON, 23 DHJETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, të martën, më 22 dhjetor, njoftoi planet për të emëruar një numër tjetër të aleatëve të tij kryesorë në borde të ndryshme qeveritare, e cila është një shenjë tjetër që presidencës së tij po i vjen fundi. Trump ka caktuar Hope Hicks, si një anëtare bordi që mbikëqyr bursën prestigjioze Fulbright. Hicks ka qenë prej kohësh një nga bashkëpunëtorët më të

afërta të Trumpit jashtë familjes së tij dhe u kthye në Shtëpinë e Bardhë këtë vit pasi u largua më herët gjatë presidencës së tij. Trump, gjithashtu, ka nominuar ish-prokuroren e përgjithshme të Floridës, Pam Bondi, si një anëtare bordi të Qendrës John F. Kennedy, si dhe sekretarin e stafit të Shtëpisë së Bardhë, Derek Lyons.

Richard Grenell, ish-ambasador amerikan në Gjermani dhe ish-ushtues i detyrës së drejtorit të Inteligjencës Kombëtare, si dhe

i dërguar i posaçëm i presidentit për dialogun Kosovë - Serbi, u emërua për të shërbyer në Këshillin Memorial të Holokaustit në Shtetet e Bashkuara. Të emëruarit janë në mesin e më shumë se 40 personave të emëruar në "pozicione kryesore" të ndryshme në panele si Komisioni i Arteve të Bukura, Bordi i Shërbimeve të Muzeut dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Korporata për Përfitimet Pensionale.

Zjarri përfshin një kamp të migrantëve në Bosnje

BIHAÇI, 23 DHJETOR - Një zjarr shpërtheu të mërkurën në një qendër migrantësh në Bosnjën veriperëndimore ku ishin vendosur 1 200 njerëz. Raportohet se nuk ka të lënduar, nga ky incident në kampin Lipa, që ndodhet rreth 30 kilometra nga qyteti i Bihaçit. Zjarri shpërtheu pasi përfaqësuesit e Organizatës

Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) filluan tërheqjen e stafit nga kampi të mërkurën duke njoftuar se ata do t'i ndalonin të gjitha shërbimet që u kishin ofruar migrantëve për tetë muajt e fundit.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) e ka shtyrë disa herë mbylljen e

kampit, i cili u hap më 21 prill dhe ishte planifikuar për akomodimin e burrave migrantë. Atyre nuk u ofrohet strehim alternativ. Kombet e Bashkuara në Bosnjë dhe Hercegovinë (BiH) kanë shprehur shqetësim për mungesën e kushteve dhe zgjidhjeve të pranueshme në këtë kamp të përkohshëm.



Në 24 orët e fundit regjistrohen edhe 12 të vdekur nga Covidi në Kosovë

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të mërkurën 271 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 066 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar edhe 12 viktima. Sipas të dhënave të këtij instituti, të mërkurën janë regjistruar edhe 417 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 10 721

EPOKA ERE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët

privatë janë testuar gjithsej 1 066 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 271 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar

12 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren katër raste (74, 67, 65, 41 vjeç), Prishtinë tri raste (87, 77, 76 vjeç), Deçan një rast (83 vjeç), Gjilan një rast (81 vjeç), Istog një rast (68 vjeç), Podujevë një rast (56 vjeç) dhe Rahovec 8

rast (66 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 49 577 prej 175 052 personave të dyshimtë me Covid dhe 1 284 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 417 pacientë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 37 572 raste, kurse numri i rasteve aktive është 10 721.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 121 raste, Fushë-Kosovë 16 raste, Podujevë 16 raste, Ferizaj 14 raste, Gjilan 12 raste, Gjakovë 11 raste, Prizren 10 raste, Pejë 8 raste, Skenderaj 8

raste, Lipjan 7 raste, Rahovec 6 raste, Deçan 5 raste, Kamenicë 5 raste, Drenas 4 raste, Mitrovicë 4 raste, Obiliq 4 raste, Novobërdë 3 raste, Shtime 3 raste, Viti 3 raste, Graçanicë 2 raste, Istog 2 raste, Klinë 2 raste, Malishevë 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Kaçanik, Mamushë dhe Vushtrri.

IKShPK-ja edhe të mërkurën u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të vijnë të testohen në SARS-CoV-2, sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë.



BE-ja ndihmon Kosovën me 24 milionë euro

EPOKA ERE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Bashkimi Evropian (BE) e ka proceduar pagesën prej 24.05 milionë eurosh për ta ndihmuar Kosovën për zbutjen e ndikimit të pandemisë së Covid-19, pastaj për ta mbështetur modernizimin e administratës publike dhe për ta forcuar menaxhimin e financave publike. Në një komunikatë të Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, thuhet se BE-ja do ta vazhdojë mbështetjen e Kosovës me fonde shumë të nevojshme për ta zbutur ndikimin socio-ekonomik të krizës së Covid-19 mbi popullsinë dhe bizneset e Kosovës.

Në komunikatë citohet komisionari për fqinjësi dhe zgjerim, Oliver Varhelyi, të ketë thënë se “përmes këtyre pagesave të mbështetjes buxhetore, ne ndihmojmë Kosovën për t’ua dalë mbanë vështirësive financiare me të cilat përballet në këtë situatë të vështirë”.

Këto mjete janë pjesë e mbështetjes nga BE-ja për përparimet që shënojnë qeveritë për zbatimin e strategjive të veta dhe për arritjen e synimeve.

Pagesat e mëparshme të BE-së lidhur me administratën publike dhe reformat e menaxhimit të financave publike në shumën prej 11.5 milionë eurosh dhe 9.97 milionë euro u disbursuan në dhjetor të vitit 2019 dhe



korrik 2020. “Qeveria ka vazhduar ta ndjekë agjendën e menaxhimit të financave publike dhe administratës publike, por duhet ta riafirmojë zotimin e saj ndaj objektivave dhe parimeve të përgjithshme të

kësaj agjende të reformave, ta sigurojë përsheptimin e ritmit të zbatimit në të ardhmen dhe të sigurojë që masat e parashikuara ekonomike dhe investimet nuk e minojnë stabilitetin makro-ekonomik në

Kosovë”, thuhet në komunikatë. Ekonomia e Kosovës është goditur rëndë nga pandemia e koronavirusit. Të martën guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se ekonomia e Kosovës pritet që të ketë një rënie ekonomike prej 7.2-përqindësh, që paraqet goditjen më të rëndë që ka pësuar në 20 vjetët e fundit.

Masat kundër përhapjes së koronavirusit, siç janë mbyllja e bizneseve dhe kufizimet e tjera, kanë ndikuar në masë të madhe në ekonominë e Kosovës duke krijuar humbje deri më tani në 1 miliard euro, sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe shoqatave ekonomike.

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) NOMINON ENVER HOXHAJ KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR TË KOSOVËS

ENVER HOXHAJ, KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR

Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka marrë besimin e strukturave të kësaj partie për kandidat për kryeministër. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se Hoxhaj është kandidati më i mirë për ta drejtuar qeverinë e ardhshme të Kosovës. Ai ka theksuar se Hoxhaj ka punuar gjatë dhe afër me dy burrështetasit e Kosovës, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. “PDK-ja me kandidatin e saj për kryeministër, Enver Hoxhaj, do të konfirmohet forca më e madhe politike në vend dhe do të dëshmohet edhe një herë si e vetmja që di të qeverisë dhe në qendër të qeverisjes së saj do të jetë qytetari”, ka deklaruar Ismaili



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 JANAR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka zyrtarizuar në mërkurën kryetarin e saj në detyrë, Enver Hoxhaj, kandidat për kryeministër në zgjedhjet që pritet të mbahen në fillim të vitit 2021. Sekretari i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se kandidati i PDK-së për kryeministër, përpos karrierës së tij akademike, ka një përvojë të gjatë institucionale dhe politike. “Jam i lumtur që qytetarëve të Republikës së Kosovës t’jua shpalos vendimin e Partisë Demokratike të Kosovës, se kandidati i saj për kryeministër është kryetari në detyrë, profesor Enver Hoxhaj. Hoxhaj, përpos karrierës akademike, ka përvojë të gjatë institucionale dhe politike”, ka thënë Ismaili në një konferencë për media. Ai ka thënë se Hoxhaj ka punuar për një kohë të gjatë me Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. Në këtë kontekst, Ismaili është shprehur i bindur se PDK-ja do të konfirmohet forca e parë politike në vend. “Ai (Enver Hoxhaj) ka punuar gjatë dhe afër me dy burrështetasit që sot nuk i kemi këtu, z. Kadri Veseli dhe z. Hashim Thaçi, duke realizuar aspiratat e qytetarëve për pavarësi dhe shtetndërtim. Partia Demokratike e Kosovës, po ashtu, hyn në këto zgjedhje me një program të qartë për nevojat e qytetarëve dhe me një ekip të gatshëm për rimëkëmbjen ekonomike dhe politike të vendit. Partia Demokratike e Kosovës, me kandidatin e saj për

kryeministër, Enver Hoxhaj, do të konfirmohet forca më e madhe politike në vend dhe do të dëshmohet edhe një herë si e vetmja që di të qeverisë dhe në qendër të qeverisjes së saj do të jetë qytetari”, ka deklaruar Ismaili.

Më tutje, Ismaili ka thënë se PDK-ja e ka mirëpritur vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili u ka hapur rrugë zgjedhjeve të reja parlamentare. Ai i ka akuzuar Vetëvendosjen dhe LDK-në për maltretimin e qytetarëve gjatë qeverisjes së tyre. “Për më shumë se një vit, që nga zgjedhjet e kaluara, kemi pasur maltretim politik dhe keqqeverisje nga të gjitha partitë politike të përfshira në qeveri, që kishte pasoja direkte për qytetarët dhe ekonominë e Kosovës. Nga dy qeveritë, Hoti dhe Kurti, kemi parë dështime të njëpasnjëshme në relacion me pandeminë, ekonominë, si dhe në përballje me Serbinë, pasojat e të cilave i kemi vuajtur si shoqëri”, ka thënë Ismaili, i cili ka shtruar se viti 2020 ka qenë më i rëndi për ekonominë e Kosovës. “Viti 2020, pa asnjë dyshim, ishte i rëndë për ekonominë tonë. Mijëra punëtorë mbetën pa punë e mijëra ndërmarrës pa përkrahje. Ishte vit i rëndë për shëndetësinë dhe personelin shëndetësor. Ndonëse në vijën e parë të frontit në përballje me pandeminë, ata nuk patën përkrahje nga asnjëra qeveri, duke i lënë të vetëm, si personelin shëndetësor, ashtu edhe pacientët, në këtë betejë të vështirë. Ishte vit i rëndë për arsimin, sportin, artin, të rinjtë, të moshuarit. Për

secilin. Ishte vit degradues për agjendën shtetërore të Republikës së Kosovës. Dhe, qeveria Hoti dhe Kurti çdo dështim të tyre ia faturuan pandemisë”, ka theksuar Ismaili. Ai ka thënë se pandemia është treguesi më i qartë i mungesës së vizionit, përvojës dhe përkushtimit të LV-së dhe LDK-së për t’u dalë

në ndihmë qytetarëve. “Pandemia është pasqyra më reale e paaftësisë së tyre. Për një vit arritën të krijojnë një kaos institucional dhe një konfuzion qytetar, duke shtyrë përpara agjenda partiake dhe duke lënë prapa interesin qytetar. Pas një viti rraskapitës, të rëndë, e politikisht të menaxhuar keq nga ata që

qeverisën, është lajm i mirë për qytetarët që këtij degradimi po i vjen fundi. Një lajm që e bën shkëputjen nga ajo çfarë pamë për një vit”, ka thënë sekretari i përgjithshëm i PDK-së. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në zgjedhje hyn pa liderin e saj, Kadri Veseli, i cili është duke u ballafaquar me drejtësinë në Hagë.

Osmani: Pas aktgjykimit të plotë të Kushtetueses caktohet data e zgjedhjeve

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, pas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me vendimin e saj për votën e deputetit Etem Arifi, ka përfunduar të mërkurën takimet me të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.

Presidenca e Kosovës ka

njoftuar se porsa të pranohet aktgjykimi i plotë i Kushtetueses, Osmani do ta caktojë datën e zgjedhjeve. "Në takime është diskutuar për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Pas përfundimit të takimeve dhe diskutimeve përmbajtjesore me të gjitha subjektet politike, u. d. presidentja Osmani ka theksuar se sapa palët ta marrin Aktgjykimin

e plotë të Gjykatës Kushtetuese, menjëherë do të caktohet data e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme. U. d. presidentja do të mbajë takime edhe me KQZ-në si dhe institucione të tjera relevante në mënyrë që organizimi i zgjedhjeve të bëhet sipas standardeve më të larta", ka njoftuar Presidenca e Kosovës.



Mustafa: LDK-ja pas zgjedhjeve do të dalë edhe më e fuqishme



PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila rrezoi Qeverinë Hoti, e zgjedhur më 3 qershor, me arsyetimin se është kundërkushtetuese. Mustafa në një deklaratë për media, me rastin e 31-vjetorit të themelimit të kësaj partie, ka theksuar se LDK-ja aktualisht

udhëheq qeverinë dhe do të jetë përgjegjëse dhe e përkushtuar që t'i kryejë detyrat kushtetuese deri në rezultatet e zgjedhjeve të ardhshme. "Kosova këto ditë po përballet me sfidën e pandemisë. LDK-ja së bashku me kuadrot më të mira po përpiqet ta japë maksimumin për ta tejkaluar edhe këtë gjendje. LDK-ja pati guximin dhe vetëdijen për të

dalë në ballë të proceseve të mëdha në kohët më të vështira, prandaj jam shumë i sigurt që në zgjedhjet e ardhshme, në bashkëpunim me të gjitha strukturat, elektorati i LDK-së do të angazhohet për rezultatin më të suksesshëm. Nga këto zgjedhje LDK-ja do të dalë edhe më e fuqishme, duke e respektuar votën dhe vullnetin qytetar", ka thënë ai. Mustafa ka

shtuar se Lidhja Demokratike e Kosovës do të vazhdojë të jetë formacioni kryesor politik në vend. "Të gjitha interesat e shtetit të Kosovës do të jenë prioriteti kryesor i politikbërjes së LDK-së", ka thënë Mustafa. Duke folur për 31-vjetorin e themelimit të LDK-së, ai ka thënë se ky përvjetor shënon një ndër ngjarjet më të rëndësishme për vendin.

"Proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova, që nga okupimi serb, liria, shpallja e pavarësisë dhe tashmë sfidat e forcimit të shtetit janë pashmangshëm të lidhura ngushtë me LDK-në", ka deklaruar Mustafa, i cili së bashku me anëtarë të Kryesisë së LDK-së të mërkurën kanë bërë homazhe te varri i ish-liderit të kësaj partie, Ibrahim Rugova.

Nisma mobilizon strukturat për zgjedhjet e parakohshme



PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Nisma Socialdemokrate ka mbajtur të mërkurën një takim me anëtarët e kryesisë dhe kryetarët e degëve, ku është diskutuar rreth përgatitjeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kërkuar nga drejtuesit e degëve që të mobilizojnë dhe angazhojnë strukturat e Nismës anekënd vendit, në mënyrë që subjekti i tyre politik të dalë sa më i fuqishëm nga ky proces i

parakohshëm zgjedhor. "Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave tona kombëtare është vet programi ynë si Nismë, dhe në funksion të kësaj duhet që të gjithë të angazhohemi maksimalisht", u ka thënë Limaj drejtuesve të degëve.

Në këtë takim, anëtarët e kryesisë dhe drejtuesit e degëve të Nismës u dakorduan që në varësi të rrethanave të këtij procesi zgjedhor, të vendoset se si do të merr pjesë Nisma në këto zgjedhje, si e vetme apo në ndonjë koalicion parazgjedhor.

Inaugurohet 'Këndi i kurajës' në Ministrinë e Drejtësisë

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, së bashku me deputeten Donika Kadaj Bujupi dhe përfaqësueset e organizatave Medica Kosova, Medica Gjakova, Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, kanë marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të "Këndit të kurajës", në hapësirën e Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë ceremonisë, ministri Selimi ka thënë se është i lumtur që në objektin e Ministrisë së Drejtësisë po vendosen punimet e grave heroina, ndërsa ka shtuar se "Këndi i kurajës" është simbolikë e ngritjes dhe vetëdijes sonë. "Ministria e Drejtësisë do të jetë zëri i të gjitha atyre grave të dhunuara gjatë luftës dhe i të gjitha viktimave të luftës. Do të jetë zëri që ka mbetur një çështje pa u përfunduar dhe ajo është prurja e drejtësisë për të gjitha këto gra", ka thënë Selimi.

Ai u zotua se do të jetë zëri i viktimave të dhunës seksuale

gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe se asnjëherë, sipas tij, nuk do të harrohen vuajtjet e tyre. "Sot unë zotohem që ky kënd do të jetë 'Këndi i kurajës' i Ministrisë së Drejtësisë. Ky 'Kënd i kurajës' do të jetë nënshkrimi ynë se ne duhet çdo ag dhe çdo muzg të jetojmë me dhimbjen e këtyre grave dhe ne kurrë nuk do t'i harrojmë ato lëndime dhe atë kurajë të ringritjes", ka deklaruar ministri Selimi.

Ndërsa deputetja e Kuvendit të Kosovës, që është incizuese e rezolutës për krijimin e "Këndit të kurajës", Donika Kadaj Bujupi, ka thënë se do të jetë kujtesa e së kaluarës, vullneti për të ecur përpara dhe guximi i atyre grave që zgjodhën jetën para vdekjes. "Si ministër i Drejtësisë keni bërë veprimin më të duhur për shkak se te këto gra ka munguar drejtësia në 20 vjetët e fundit. Ju jeni i pari që keni ofruar një kënd brenda institucionit që nuk është vetëm fizikisht, por që ka një kuptim shumë më të plotë, që këto gra ta kenë qasjen dhe prioritetin e Ministrisë së Drejtësisë derisa



drejtësia të vihet në vend", ka thënë deputetja Kadaj Bujupi. Ndërsa përfaqësueset e organizatave joqeveritare që merren me gratë e mbijetuarat të dhunës gjatë luftës në Kosovë dhe riintegrimin e tyre,

vlërësuan lart vendosjen e "Këndit të kurajës" brenda Ministrisë së Drejtësisë, duke thënë se kjo iniciativë është një vëmendje e shtuar institucionale për të kërkuar drejtësi për viktimat e dhunës

seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

"Këndi i kurajës" do të ketë të ekspozuara artizanale të punuara nga viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë.



Pjesëtarët e FSK-së realizojnë me sukses trajnimin 'Simboli i ujkut'

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Në trajnimin trejavësh pjesëtarët e njësive të Komandës së Forcave Tokësore kanë realizuar trajnimin "Simboli i ujkut". Ata kanë demonstruar shkathtësitë e tyre taktike dhe të mbijetesës përmes testimeve fizike,

ligjëratave, aktiviteteve sulmuese, repelimit sfidues, reagimit ndaj kontaktit, kalimit të pengesave ujore në ujën e akullit dhe operacionin final 72-orësh dhe 110 kilometra marshim në këmbë me 30 kilogramë pajisje ushtarake.

"Simboli i ujkut" është një ndër trajnimet më të avancuara dhe më sfiduesi për pjesëtarët e FSK-së, ku kërkohet operim i ekipit me mbështetje dhe motivim të njëri-tjetrit për të arritur përfundim të suksesshëm të trajnimit.

Nënshkruhet memorandumi në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Jordanisë

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Pas procesit paraprak bashkëpunues përgatitor, sot u zyrtarizua partneriteti bilateral në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Jordanisë në fushën e mbrojtjes. Memorandumi i mirëkuptimit u nënshkrua në distancë për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19, nga shefi i shtabit të përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Jordanisë, gjeneralmajor Yousef A. Alhnaity, në emër të palës jordanize dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant

Rrahman Rama, me autorizim edhe të ministrit Quni, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Si marrëveshja bilaterale e 15-ta me radhë e bashkëpunimit të Republikës së Kosovës me vendet e tjera në fushën e mbrojtjes, ka për qëllim bashkëpunimin në fushat si: luftën kundër terrorizmit, operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, arsimimin dhe stërvitjet ushtarake, hulumtimin në industrinë e mbrojtjes si dhe shkëmbimin e përvojave në nivel ekspertësh.



Rrugë e gjatë deri tek arritja e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë

Pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shkuarje në zgjedhje të parakohshme, dialogu do të vazhdojë të diskutohet gjatë fushatës zgjedhore dhe do të jetë ndër temat qendrore edhe për qeverinë pasardhëse. Kështu është thënë në diskutimin e tretë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) “Viti i ri, dialogu i vjetër?”

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 DHJETOR- Instituti Demokratik të Kosovës (KDI) ka zhvilluar diskutimin e tretë online “Viti i ri, dialogu i vjetër?”, në të cilin kanë marrë pjesë njohës të dialogut dhe të çështjeve të ndërlidhura me të, si dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile.

Në hapje të diskutimit, Jeta Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, ka thënë se, pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shkuarje në zgjedhje të parakohshme, dialogu do të vazhdojë të diskutohet gjatë fushatës zgjedhore dhe do të jetë ndër

temat qendrore edhe për qeverinë pasardhëse.

Ajo ka theksuar se gjatë vitit 2020, përveç ndryshimit të dy qeverive, që kishte ndodhur edhe për shkak të mospajtimeve reciprocitetit, ka pasur zhvillime të rëndësishme në dialog, përfshirë arritjen e marrëveshjes në Uashington për normalizimin ekonomik, si dhe rifillimin e dialogut pas 20 muajsh pezullimi, pas emërimit të Miroslav Lajçakut emisar i posaçëm i BE-së.

Bodo Weber, bashkëpunëtor i lartë në Këshillin e Politikave të Demokratizimit (DPC), duke folur për periudhën rreth tre vjet e gjysmë që nga fillimi i procesit

të dialogut përfundimtar, ka pohuar se ky proces ka qenë i privatizuar nga aktorë në të dy vendet si dhe te faktori ndërkombëtar, duke rrëshqitur edhe në diskutime për shkëmbimin e territoreve.

Gjithashtu, ai potencoi se për shkak të mungesës së koherencës në politikat dhe qëndrimet e ndjekura nga aktorët ndërkombëtarë, nuk kanë arritur rezultatet e dëshiruara. Weber e vlerësoi rolin e emisarit të BE-së në dialog, Miroslav Lajçak, si jokonstruktiv. Lidhur me rifillimin e dialogut ai theksoi nevojën e rikthimit të dialogut në binarët fillestarë, duke u ndërtuar mbi parime të qarta në frymën evropiane.

Miodrag Miliçević, drejtor ekzekutiv i OJQ Aktiv, foli për rëndësinë e pjesëmarrjes së komunitetit serb në kuadër të dialogut, si dhe faktit që interesat e serbëve lokalë nuk janë përfaqësuar në kuadër të këtij procesi. Gjithashtu, ai trajtoi pritshmëritë nga rezultatet e marrëveshjeve në

përgjithësi, si dhe integrimin e plotë të serbëve përmes arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Në anën tjetër, ai theksoi që pozicionet dhe qëndrimet diametralisht të kundërta të palëve, dhe qëndrimi i Lajçakut se palët duhet ta definojnë normalizimin, paraqesin një element të rëndësishëm të këtij procesi. Ai ka rekomanduar që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë të zhvillohet në Prishtinë dhe Beograd, në vend se në Bruksel.

Sa i përket rolit të administratës së re të udhëhequr nga presidenti Biden, panelistët vlerësuan që pozicioni i tij është shumë i qartë në raport me Kosovën si shtet i pavarur, duke përjashtuar mundësinë e prekjes së kufijve dhe përcaktimit e orientimit euroatlantik të Kosovës si të panegociueshme.

Madje ata vlerësuan që pikërisht pozicionimi i qartë i ShBA-së do të ndikojë edhe te BE-ja t'i ripërcaktojë pozicionet karshi procesit, si dhe e kjo e fundit të marrë përgjegjësinë që

i takon për procesin.

Të pranishmit u pajtuan që arritja e një marrëveshje në interval të shkurtër kohor, sidomos për çështje muajsh, është pothuajse e pamundur të arrihet. Faktor që do të luajë rol në këtë drejtim, u tha që është pandemia, meqë qeveritë do ta prioritojnë luftën ndaj pandemisë, para shkuarjes dhe zhvillimit të bisedimeve në dialog. Sidoqoftë, u tha që asnjëra palë nuk duhet ta shfrytëzojë procesin e dialogut për përfitime politike, siç është bërë deri më tani, por që të orientohen për arritjen e një marrëveshje të qëndrueshme.

Një marrëveshje gjithëpërfshirëse, jo domosdoshmërisht do t'i zgjidhë të gjitha çështjet e lidhura me subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Por, u theksua që funksionimi i brendshëm i Kosovës duhet të mbetet prioritet, duke marrë parasysh rastin e Bosnjës - që ka subjektivitet të jashtëm të konsoliduar, por nuk ka funksionalitet të brendshëm.



Pezullohen linjat ajrore me Britaninë e Madhe

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nxjerrë të mërkurën vendim për masa të veçanta për mbrojtje nga përhapja e infeksionit Covid-19 për pezullimin e të gjitha linjave ajrore të fluturimit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” nga Britania e Madhe për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas. “Të gjithë qytetarët që vijnë

nga Britania e Madhe në pikat tokësore obligohen të vetizolohen për 14 ditë në shtëpitë/banesat e tyre. Vendimi udhëzon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të marrin vendimet dhe veprimet e nevojshme në përputhje me fushat e përgjegjësitë administrative të tyre me qëllim të zbatimit të këtij

vendimi. Për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nuk respektojnë këto masa, organet kompetente obligohen t'i shqiptojnë masat ndëshkimore konform Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Vendimi është në fuqi që nga sot”, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.



Duhen katër vjet për t'u rimëkëmbur ekonomia e Kosovës

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Që ekonomia e Kosovës të kthehet në nivelet e zhvillimit që ka pasur para fillimit të pandemisë me Covid-19, do të duhen deri në katër vjet, thotë kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, ndërkaq më optimistë për rimëkëmbjen ekonomike janë përfaqësuesit e Qeverisë në detyrë të Kosovës. Si rezultat i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, sipas projeksioneve të Bankës Qendrore të Kosovës, ekonomia e Kosovës do të shënojë rënie deri në 7.2 për qind në vitin 2020.

Për të mbuluar këtë rënie ekonomike, zëvendësministri në detyrë i Financave, Agim Krasniqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se duhet pak më shumë se një vit. "Tash po shihet se nuk do të ketë më mbyllje totale. Mbi bazën e zvogëluar të vitit 2020, planifikojmë që në vitin e ardhshëm të kthehemi në një rritje prej 5.5 përqindësh. Për ta mbuluar minus 7.2 për qind rënie ekonomike, nevojitet pak më shumë se një vit", thotë Krasniqi.

Nuk mund të pritët rimëkëmbje e shpejtë

Një rimëkëmbje kaq të shpejtë të ekonomisë së Kosovës nuk e shohin përfaqësuesit e bizneseve. Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë se Kosova është vonuar për mbështetje të ekonomisë për ta rimëkëmbur atë për një vit. "Për rikthimin e ekonomisë së Kosovës si para pandemisë duhet deri në katër vjet. Vendet e tjera kanë marrë hapa konkretë për ekonominë, Kosova jo. Kur ta kufizosh aktivitetin ekonomik, duhet edhe ta mbështetësh", thotë Shahini.



Bizneset në Kosovë gjatë nëntë muajve të pandemisë kanë raportuar humbje të mëdha financiare. Humbjet më të mëdha ishin në muajin mars dhe prill, ku shumica e aktiviteteve ekonomike ishin komplet të mbyllura. E nga muaji maj qeveria kishte lejuar lëvizjet dhe veprimtarinë e bizneseve, por me masa kufizimi dhe duke respektuar masat mbrojtëse, si distancën fizike dhe mbajtjen e maskave.

Deri më tani, sipas Administratës Tatimore të Kosovës, llogaritet se bizneset shënuan humbje deri në 1.2 miliard euro.

Të hyrat për buxhetin e shtetit deri në fund të vitit, sipas Ministrisë së Financave, do të jenë 300 milionë euro më pak. Gjatë vitit 2020 këto humbje të bizneseve nuk arritën të mbulohen nga shteti.

Nga Pakoja Emergjente Fiskale dhe për bizneset Qeveria e Kosovës ka ndarë jo më shumë se 150 milionë euro deri më tani.

Rimëkëmbja ekonomike përmes ligjit

Rimëkëmbja ekonomike, sipas Qeverisë në detyrë të Kosovës, do të vazhdojë me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike i cili ka filluar të zbatohet pas miratimit të tij më 4 dhjetor. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se qytetarët dhe bizneset do të përfitojnë rreth 600 milionë euro nga ky ligj. "Para Vitit të Ri pjesa më e madhe e këtyre fondeve do të futen në ekonomi dhe buxhetin e familjes, me shpresë që në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm të shpërndajmë pjesën tjetër të fondit për rimëkëmbje dhe të kthehemi në normalitet në mesin e vitit 2021", ka thënë Hoti.

Viti 2021, vit i rikuperimit të ekonomisë

Rimëkëmbja ekonomike do të varet shumë nga masat që do të merren për parandalimin e

përhapjes së Covid-19 dhe sa do të zgjasë pandemia. Masat aktuale në fuqi janë të ndara në komuna, të përcaktuara varësisht nga numri i të infektuarve. Në disa komuna ka edhe kufizim të lëvizjes dhe mbyllje të aktivitetit ekonomik nga ora 20:00 deri në orën 5:00. Bedri Hamza, anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Transfere, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se viti 2021 mund të jetë vit i rikuperimit të ekonomisë dhe se ky rikuperim do të varet nga zhvillimet. "Nëse merren masa adekuatë dhe nëse ka mundësi që kjo pandemi ta ketë fundin, pres që viti 2021 të jetë vit i rikuperimit. Në çfarë niveli do të jetë rikuperimi, varet nga dinamika e zhvillimeve në vend", thotë Hamza.

Projektbuxheti i vitit 2021, në fokus ekonominë

Rimëkëmbja e ekonomisë është projektuar edhe në Projektbuxhetin e Kosovës për

vitin 2021, i cili ka një vlerë prej 2.4 miliardë eurosh. Ky projektbuxhet në fokus ka sektorin e shëndetësisë dhe rimëkëmbjen ekonomike. Por, votimi i Projektligjit për Buxhetin e vitit 2021 ka mbetur peng i situatës së re të krijuar në Kosovë, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila e konsideroi zgjedhjen e qeverisë së udhëhequr nga Avdullah Hoti, jokushtetuese. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se po angazhohet maksimalisht që përbërja aktuale e Kuvendit ta miratojë buxhetin për vitin e ardhshëm. Për rimëkëmbje ekonomike, me këtë Projektbuxhet janë paraparë të ndahen mbi 182 milionë euro, që ka për qëllim përkrahjen e bizneseve që kanë pësuar humbje nga pandemia e shkaktuar nga koronavirusi.

Për t'i ndihmuar bizneset që ato të arrijnë të rimëkëmben, Qeveria e Kosovës ka lansuar edhe Fondin për Garanci Kreditore.

Ky fond me një vlerë prej 60 milionë eurosh ofron mbështetje për ndërmarrjet private dhe ato publike në sektorë të ndryshëm, përmes instrumenteve të reja për garanci kreditore, që nënkupton rritjen e përqindjes së garancisë në 80 për qind.

Ekonomia e Kosovës në vazhdimësi është përballur me nivel të ulët të zhvillimit. Viti 2019 është përmbyllur me një rritje ekonomike prej 4.2-përqindësh, e cila ka qenë e pamjaftueshme për ta adresuar problemin e papunësisë.

Buxheti i Kosovës në vitin 2019 ishte 2.3 miliardë euro. Papunësia në Kosovë është rreth 30 për qind dhe deficitin vjetor tregtar në Kosovë më shumë se 3 miliardë euro.

OAK-u nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Odën Tregtare Kosovaro -Turke

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit, krijimit të lehtësirave për bizneset, shkëmbimit të të dhënave për përkrahje të bizneseve të kompanive anëtare, bashkëpunimit tregtar të kompanive anëtare përmes korrespondencës dhe afrimit të kompanive në sferat e biznesit ku të njëjtët operojnë, Oda e Afarizmit të Kosovës ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Odën Tregtare Kosovaro-Turke e cila nga viti 2008



funkcionon në Kosovë. Përmes kësaj marrëveshje bashkëpunimi Oda e Afarizmit e Kosovës do t'i

shkëmbejë të dhënat dhe dokumentacionin të cilin e ka në dispozicion, do ta ndihmojnë njëra-tjetrën për

organizimin e ngjarjeve të ndryshme me interes për kompanitë anëtare, si: panairë, B2B takime, prezantime, forume, seminare, konferenca dhe aktivitete të ngjashme promovuese; ta mbështesin dhe lehtësojnë kontaktet në mes të anëtarëve të tyre, që do të ndikojnë në afrimin e kompanive anëtare për realizim të planeve dhe aktiviteteve të tyre biznesore. Kryetari i bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, me rastin e nënshkrimit të

memorandumit të bashkëpunimit, ka thënë se do të kenë një bashkëpunim praktik, që bashkërisht të llojnë për rregullimin e disa çështjeve me rëndësi jetike për të bërit biznes në Kosovë. Kryetari i Odës Tregtare Turke në Kosovë, Abdurrahman Balkız, ka falënderuar OAK-në me rastin e nënshkrimit të këtij memorandumit të bashkëpunimit, duke potencuar faktin se ky memorandum i bashkëpunimit do të jetë praktik dhe implementues.

Importi në muajin nëntor kapi shifrën 305.7 milionë euro

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin nëntor 2020.

Sipas ASK-së, të dhënat nga tregtia e jashtme të mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për (-0.9 për qind) në muajin nëntor 2020, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, gjegjësisht në vlerë prej 259.9 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 262.2 milionë eurosh në vitin 2019. "Eksporti mbulon importin me 15 për qind. Eksporti i mallrave në muajin nëntor 2020 kishte vlerën 45.7 milionë euro, ndërsa importi 305.7 milionë euro, që është një rritje prej 29.4-përqindësh për eksport dhe 2.7 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se, sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 34.2 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14.8 për qind artikujt e ndryshëm të prodhuar; 11.8 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9.5 për qind

ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 6.4 për qind produktet bimore; 4.4 për qind produktet minerale; 4.4 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 14.1 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12.2 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.2 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10.5 për qind produktet minerale; 9.3 për qind produktet e industrisë kimike; 8 për qind mjetet e transportit; 7.1 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj.

Sipas ASK-së, sa iu përket vendeve të BE-së, partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Italia (11 për qind), Gjermania (9.8 për qind), Holanda (4.2 për qind). "Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 16.9 milionë euro, ose rreth 37 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 8.5-përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Italia (11 për qind), Gjermania (9.8 për qind), Holanda (4.2 për qind) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 139 milionë euro, ose 45.5 për



qind e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-1.8 përqindësh). Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (13 për qind), Italia (7.3 për qind), Greqia (3.6 për qind), Polonia (3 për qind), Sllovenia (3 për qind) etj", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas ASK-së, në muajin nëntor 2020 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 18.1 milionë euro, ose 39.7 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 32.1-

përqindësh. "Partnerët kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (17.8 për qind), Maqedonia e Veriut (10.6 për qind), Serbia (6.5 për qind) dhe Mali i Zi (3.7 për qind). Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s, në muajin nëntor 2020, arritën në 64.1 milionë euro, ose 21 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 55.4-përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (6.6 për qind), Serbia (6.5 për qind) dhe Maqedonia e Veriut

(5.5 për qind). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 10.6 milionë euro, ose 23.4 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: Zvicra (10.1 për qind) dhe ShBA-ja (7.5 për qind)", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 102.4 milionë euro, ose 33.5 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (11.9 për qind) dhe Kina (10.6 për qind).

Të gjitha rrugët në Kosovë janë të hapura për qarkullim



PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se në mbarë vendin kompanitë e kontraktuara po kujdesen që rrugët të jenë lehtësisht të kalueshme për automjetet. Me qëllim të sigurisë në komunikacion, në

disa zona, sidomos ato malore, është intervenuar me hedhje të kripës për ta evituar krijimin e shtresave të akullta nga rënia e temperaturave dhe mjegulla.

Sipas raporteve nga menaxherët mbikëqyrës të

MI-së, nga kompanitë, në mëngjes dhe mbrëmje, është intervenuar në rrugët rajonale Mitrovicë - Bajgorë (R129), Deçan - Koznjër (R108), atë nacionale N9 në zonën e Dollcit, dhe akset rrugore Pejë - Kullë e Doganaj - Gllboqicë.

Kripë është hedhur edhe në zonat turistike malore si Bogë e Prevallë.

Kompanitë e kontraktuara, me tërë makinerinë, bashkë me inxhinierët e MI-së, janë në mbikëqyrje të vazhdueshme të të gjitha

rrugëve nacionale, rajonale, magjistrale dhe autostradave gjatë 24 orëve.

Ministria e Infrastrukturës ka bërë thirrje për kujdes të shtuar në vozitje me qëllim të evitimit të rreziqeve në komunikacion.

Haziri: Këndi Arkivor i Shqipërisë, shumë shpejt në Bibliotekën e Gjilanit

GJILAN, 23 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar të mërkurën marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë për dhënien e Këndit Arkivor në bibliotekën e qytetit. Me anë të kësaj marrëveshje, i mundësohet

komunitetit shkencor të Gjilanit që të ketë qasje të plotë në dokumentin arkivor, si të ishte në Tiranë, pa pasur nevojën e udhëtimit drejt kryeqendrës shqiptare. Haziri, pasi e nënshkroi këtë marrëveshje, tha se ndihet i lumtur që një copë e Shqipërisë tashmë shumë shpejt do të vijë në Gjilan. Ai

ka thënë se bashkëpunimi i Komunës së Gjilanit me Republikën e Shqipërisë ka qenë i shkëlqyeshëm, duke e falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme. Pas kësaj marrëveshje, do të fillojnë procedurat për hapjen e Këndit Arkivor, i cili pritet të hapet shumë shpejt në bibliotekën e qytetit.



Përurohen investimet në pjesën e vjetër të qytetit të Gjakovës

GJAKOVË, 23 DHJETOR (ER) - Me përfundimin e punimeve në pjesën e vjetër të qytetit të Gjakovës u përuan punimet gjatë të cilave me intensitet u punua gjatë gjithë vitit. "Simbolikisht po shënojmë përfundimin e punimeve në rrugë të qytetit të vjetër dhe pjesën dërrmuese të infrastrukturës përcjellëse që janë trotualet dhe infrastruktura nëntokësore. Në pjesën e vjetër të qytetit rrugët të cilat duhet të jenë me kubëza kanë përfunduar. Kanë mbetur vetëm edhe disa finesa përfundimtare të cilat do të realizohen gjatë vitit të ardhshëm. Do të rregullohet çështja e parkingjeve, shëtitorja qendrore e Çarshisë si dhe do të bëhet renovimi i objektit të QKMF-së", ka thënë kryetari i komunës, Ardian Gjini.

Ai ka falënderuar qytetarët e Komunës së Gjakovës, me paratë e të cilëve është investuar 80 për qind për realizimin e punimeve në shëtitoren e lumit Krena e të cilat kanë ndodhur me buxhet suplementar, pra me tejkalim të të hyrave vetjake. Punimet e zhvilluara në infrastrukturën rrugore të çarshisë së vjetër janë realizuar me buxhet prej



400 000.00 eurosh nga granti i Helvetas e MAPL dhe rreth 400 performancës që është 000.00 euro të tjera nga të financuar nga Demos hyrat vetjake.

Bulliçi nënshkroi marrëveshje me Caritasin për përkrahje në edukimin parafillor

PODUJEVË, 23 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi, ka pritur të mërkurën përfaqësuesit e Caritasit në Kosovë me të cilët ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi për edukimin parafillor. Gjatë takimit Bulliçi dhe udhëheqësi i zyrës së Caritasit në Kosovë, Kreshnik Basha, kanë biseduar për thellimin e bashkëpunimit në projekte për arsimin parafillor, bujqësi, riintegrim dhe riatdhesim. Marrëveshja e nënshkruar mes tyre parasheh nxitjen e edukimit të hershëm përmes trajnimeve të edukatoreve që

do të bëhet në dy grupe si dhe investimin në pajisjet e ambienteve të arsimit parafillor për pesë klasa mësimi, që do të financohet nga tre donatorë nga Lihtanshtajni. Bulliçi ka falënderuar përfaqësuesit e Caritasit për projektet e realizuara deri tani në Komunën e Podujevës, veçmas për marrëveshjen e nënshkruar nga e cila do të përfitojnë fëmijët.

Gjithashtu, kryetari Bulliçi u zotua për thellim të bashkëpunimit duke premtuar se mekanizmat adekuatë të Komunës do të jenë në shërbim të realizimit të projekteve me Caritasin.



Drejtorja e Bujqësisë vazhdon shpërndarjen e pajisjeve bujqësore, përfitojnë 35 fermerë

KAMENICË, 23 DHJETOR (ER) - Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka bërë shpërndarjen e pajisjeve bujqësore për 35 fermerë të Kamenicës. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka uruar fermerët për përfitimin e këtyre pajisjeve. "Edhe 35 fermerë nga Kamenica përfituan pajisje bujqësore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Sot bashkë me drejtorin e Bujqësisë, Naim Arifin dhe stafin e kësaj drejtorie, kemi shpërndarë 15 kositëse bari dhe 20 mbledhëse bari. Para pak ditësh kemi ndarë pajisje

bujqësore edhe për 40 fermerë. Urime përfituesve!", ka thënë ai.

Edhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naim Arifi, ka thënë se në vazhdimësi janë duke i mbështetur fermerët. "Qytetarët e komunës sonë janë prioriteti ynë, andaj çdo ditë angazhohemi që t'ua ofrojmë kushtet bazë për lehtësimin e punëve të tyre", u shpreh ai.

Drejtorja e Bujqësisë ka shpërndarë pajisje bujqësore ditë më parë edhe për 40 fermerë të Kamenicës.



2020, vit i mbrapshtë i Kosovës



Shkruan: Ismail SYLA

1. Viti 2020 në tërësi po shkon si vit i pandemisë, vit i Covid-19. Vetëm në Kosovë nga infeksionet me këtë virus vdiqën 1 161 persona. Çrregullimi i jetës është i dukshëm edhe në mesin tonë. Pasojat kanë filluar të ndihen në proporcion me përmasat e të gjitha fushave të jetës, aq sa përfaqëson Kosova në rajon e më gjerë, si ekonomi, jetë institucionale dhe qarkullim të mallrave dhe njerëzve.

2. Më 24 qershor 2020 doli në pah ajo që me vite sillej si një re e zezë mbi kokën politike të Kosovës. Një komunikatë e Gjykatës Speciale e bëri të ditur për opinion publik se subjekt i Prokurorisë së Dhomave të specializuara ishte presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli. Kjo komunikatë ishte minë e kurdisur që shpërtheu gjatë orarit të udhëtimit të presidentit Thaçi drejt Uashingtonit.

3. Zhvillimet ndërmjet periudhës 24 qershor deri më 5 nëntor 2020 karakterizohen me pritje të afatit gjashtëmujor se a do ta nënshkruaj aktakuzën a jo gjykatësi i procedurës paraprake. Dy gjëra që mua më bënë përshtypje të thellë ishin, nën një: arrestimi i krerëve të OVL të UÇK-së, Nasim

Haradinaj dhe Hysni Ngucati. Ata u viktimizuan si “cjepër biblike” nga Gjykata Speciale në vend të atyre që i bënë të rrjedhin dokumentet konfidenciale të EULEX-it, dhe, nën dy: deklarimi i avokatit të populli të Gjykatës Speciale Pietro Spera, i cili godet “viktimat”, e zakonisht ombudspersoni “anon” nga pala e dëmtuar.

4. Më 5 nëntor 2020 u realizua një akt me peshë dramatike. Arrestimi i presidentit Thaçi. Prej ambicies së prokurores Carla del Ponte që “të ketë punë me të” pas përfundimit të luftës dhe deri te dita e dorëheqjes nga posti i presidentit gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregull, ka një hark kohor 21 vjeçar. Hashim Thaçi pas përfundimit të luftës ishte pjesë e çmilitarizimit të UÇK-së, e krijimi të partisë politike (PDK), e fitoreve të zgjedhjeve më 2007. Ishte kryeministër që shpalli pavarësinë e Kosovës dhe që e drejtoi qeverinë e vendit deri më 2014. Në vazhdim që zëvendës kryeministër dhe prej 7 prillit 2016 President i Kosovës.

5. Arritja e një momenti kur vihen pranga në duart e një lideri meritore për historinë e re të Kosovës, njeriut që kryesoi delegacionin e Kosovës në Rambouillet, njeriut që shpalli pavarësinë e Kosovës, politikanit dhe diplomatit më propeëndimor që ka prodhuar historia e Kosovës, nuk është aspak e lehtë për vetë qenësinë e kombit. Jashtë botës së kundërshtarëve politikë, jashtë qarqeve armiqësorë të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, arrestim i njerëzve të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës (Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit etj) është goditje, fyerje dhe prekje e integritetit kombëtar dhe historik të Kosovës.

6. Shprehje e frymës perëndimore dhe e lojalitetit, e jo miopi politike, ishte edhe themelimi i Gjykatës speciale me seli në Hagë. Thirrja për qetësi dhe “dorëzimi” paqësor gjatë procedurës së arrestimit është shprehje e seriozitetit dhe kulturës së burrshtetasve që përcaktim jetësor i kanë veprimet madhore në favor të ngritjes dhe forcimit të shtetësisë së Kosovës.

7. Në tekstin e aktakuzës së redaktuar, të publikua nga Gjykata Speciale e Hagës, gjen kuptimin e saj shprehja shqipe “pllakos”, kur diçka e fortë dhe me peshë të rëndë, si pllaka e shtëpisë, të bie mbi kokë. Është fajësimi për krime kundër njerëzimit. Ta ngarkosh UÇK-në ke krime kundër njerëzimit dhe ta baras vlerësosh atë me krimet e ushtrisë dhe policisë serbe të periudhës së Sllobodan Millosheviqit është huqja më e madhe e vënë në krahët e peshores së drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare. Analisti britanik James Pettifer në librin “Ekspres i Kosovës” më së miri e gjen relacionin dhe proporcionin e UÇK-së dhe ushtrisë serbe. Derisa shteti serb kishte një ushtri me doktrinë dhe hierarki shtetërore, sipas tij, UÇK-ja kishte tri elemente: kallashnikovin, NOKIA-n dhe çorganizimin.

8. Ndryshimi i narrativit historik, devijimi dhe rishkrimi i historisë së Kosovës është i

dukshëm dhe i kamufluar në tekstin e aktakuzës. Derisa në paragrafët 13, 14 dhe 15 të “Historikut” përmendet emri i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në paragrafin e 16 tek “Elementët kontekstualë” papritmas UÇK-ja shndërrohet në NKP (Ndërmarrje Kriminale të Përbashkët) e cila paska kryer “një sulm gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile të kundërshtarëve (përkufizuar më poshtë) në Kosovë dhe në zona të Shqipërisë Veriore”. Si duhet kuptuar sintagmat “sulm gjerësisht i përhapur” dhe “kundër popullatës civile të kundërshtarëve”. Thua në Kosovë kishte luftë civile gjerësisht të përhapur mes shqiptarëve!

9. Në paragrafin e 17 dalin përmasat e gjoja trysnisë “mbi popullatën e vënë në shënjestër në tërësi, për të parandaluar kundërshtimet ndaj UÇK-së/QPK-së dhe për të detyruar bashkimin absolut rreth tyre. Të bësh një veprim të caktuar mbi popullatën në tërësi dhe të arrish rreth vetes bashkimi absolut, nuk është luks i asnjë sistemi diktatorial dhe i asnjë totalitarizmi kudo në botë.


10. Ndërkaq, në paragrafin 25 formulohet një qëndrim shumë problematik dhe kontestues lidhur me intervenimin e NATO-s dhe largimin me dhunë të shqiptarëve nga Kosova të bërë nga forcat ushtarake dhe policore serbe: “Më 24 mars 1999, forcat e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (‘NATO’) filluan bombardimet ajrore kundër qeave në Kosovë dhe Serbi. Si pasojë,


dhe për shkak të operacioneve në shkallë të gjerë të forcave të RFJ-së, ushtarë të UÇK-së dhe një numër shumë i madh civilësh shqiptarë të Kosovës shkuan nga Kosova në Shqipëri, ku UÇK-ja kishte tashmë objekte dhe personel të saj”.

Në këtë paragraf nënkuptohet se një numër shumë i madh i civilësh shqiptarë nuk u dëbuan me dhunë, po shkuan (vullnetarisht) në Shqipëri si shkak i bombardimeve të NATO-s dhe operacioneve të forcave të RFJ-së. Është për keqardhje që planifikim dhe ekzekutimi i spastrimit etnik të Kosovës të përshkruhet me fjalën “u larguan”. Ky interpretim i dëbimit të gjysmë milioni shqiptarë nga vendi i tyre është shumë i favorshëm për shtetin diktatorial të Millosheviqit.

11. Historiani francez Serge Matais në shkrimin e tij “Kosovë. Cila është dobia e një gjykate të posaçme dhe a ia vlen të hiqet qafe?”, pos tjerash flet edhe për arsyen pse të mos kthehet kjo gjykatë në Kosovë. Arrestimet e bëra kanë shkaktuar fenomenin e rënies së pllakës mbi kokë. As për Perëndimin demokratik dhe liberal nuk është mirë që UÇK-ja të konvertohet në NKP. Besoj që koha do të tregojë se shoshitja e njerëzve të UÇK-së në Hagë s’është gjë tjetër pos kënaqje e një trilli ndërkombëtar, ndërprerje e karrierës politike të disa protagonistëve, fatkeqësi individuale e të arrestuarve për të kaluar kohën e çmuar në burg, vënie në vështirësi ekonomike dhe shpirtërore të familjeve të tyre etj.

Prishtinë, dhjetor 2020





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Munishi, pas shkarkimit: Lamtumirë Suharekë!

FC Ballkani dhe Ismet Munishi kanë ndarë rrugët të dielën. Klubi nga Suhareka dhe presidenti Arsim Kabashi e kanë falënderuar trajnerin për kontributin e dhënë, kurse Munishi ka falënderuar qytetin e Suharekës për mbështetjen e vazhdueshme. Pasardhës i tij në krye të Ballkanit pritet të jetë trajneri nga Shqipëria, Orges Shehu



pajtuam t'i ndajmë rrugët dhe e falënderoj për korrektësi gjatë gjithë bashkëpunimit dhe, po ashtu, ishte shumë korrekt në bisedime për anën financiare dhe kompensimin e kontratës. I lus mediat të mos sulmohet klubi im dhe presidenti. FC Ballkanit, 'Xhebrailave' dhe lojtarëve të mi të dashur u dëshiroj suksese në rrugën drejt titullit. Jam shumë krenar me punën time dhe me atë çfarë arritëm deri këtu", ka shkruar Munishi, i cili konsiderohet më meritori për ngritjen e nivelit të Ballkanit në Superligë. Kjo skuadër e përfundoi sezonin vjeshtor në pozitën e dytë në tabelë, kurse për një pjesë të madhe të kohës ishte në pozitën e parë të tabelës. Pasardhës i Munishit në krye të Ballkanit pritet të jetë Orges Shehu, por gazeta ka mësuar se presidenti i klubit ka biseduar me disa trajnerë dhe ende nuk ka asnjë vendim zyrtar.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Skuadra e Ballkanit nga Suhareka e ka shkarkuar të mërkurën trajnerin Ismet Munishi. Lajmin për gazetë e ka konfirmuar një burim brenda klubit, kurse gjatë ditës shkarkimi është zyrtarizuar edhe nga faqja zyrtare e klubit suharekas në "Facebook". "Klubi ka vendosur ta ndërpresë bashkëpunimin me trajnerin Ismet Munishi pas një vit e gjysmë të kaluar së bashku në sfidat e shumta sportive.

Klubi e falënderon përzemësisht Munishin për shumë vlera dhe punën profesionale të cilat i ka sjellë në klubin tonë duke e ngrehur në nivel edhe më të lartë sesa që ishte parë. Faleminderit i dashur trajner! Shumë suksese në karrierën tuaj!", thuhet në njoftimin e FC Ballkani. Një reagim pas këtij vendimi pati edhe presidenti i klubit, Arsim Kabashi. Ky i fundit e ka vlerësuar lart Munishin dhe e ka falënderuar për kontributin e madh që ka dhënë në Klubin e Ballkanit. "Faleminderit, faleminderit dhe faleminderit i

dashur trajner! Do të jesh një mik i përjetshëm për mua dhe familjen time. Të uroj suksese të pafundme", ka shkruar Kabashi. Presidentin Kabashi, Klubin e Ballkanit dhe qytetin e

Suharekës e ka falënderuar trajneri Ismet Munishi. "Lamtumirë Suharekë! Faleminderit për respektin dhe mikpritjen suharekas. Me presidentin Arsim Kabashi u

Rahoveci triumfon ndaj Prishtinës, Ylli ndaj Trepçës

PRISHTINË, 23 DHJETOR - KB Rahoveci ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës në udhëtim 81:88 (12:20, 12:17, 25:27, 32:24), në kuadër të xhiros së dhjetë të Prince Caffë Superligës së Kosovës në basketboll. Kjo ishte fitorja e gjashtë radhazi për Vreshtarët. Mysafirët e nisën ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 12:20, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, 12:17, për të shkuar në pushim me rezultat 24:37. Lojë më e barabartë u zhvillua në

periodën e tretë, sidoqoftë, Rahoveci administroi mirë rezultatin dhe kjo pjesë përfundon 25:27. Në 10 minutat e fundit, Prishtina fitoi 32:24, megjithatë, ishte e pamjaftueshme dhe Rahoveci triumfoi në fund me shifrat 81:88. Te Sigal Prishtina u dalluan Fisnik Rugova me 22 pikë e shtatë kërcime dhe Daniel Lekndreaj me 20 pikë e nëntë kërcime, kurse te Rahoveci më të mirët në parket ishin Isaiah Traylor me 28 pikë e gjashtë asistime dhe Marvin



Jones me 24 pikë. Sigal Prishtina ka tri fitore dhe shtatë humbje, kurse Rahoveci tetë

fitore dhe dy humbje. Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore bindëse ndaj Trepçës me rezultat 91:54 (22:5, 29:9, 19:23, 21:17), në kuadër të xhiros së dhjetë të Prince Caffë Superligës së Kosovës në basketboll. Therandasit e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke fituar bindshëm çerekun e parë 22:5. Ylli dominoi edhe në periudhën e dytë, që e fitoi me 20 pikë dallim 29:9, duke shkuar në pushim me rezultat 51:14. Epërsia e lartë ishte e mjaftueshme që vendasit të

jenë më të relaksuar në pjesën e dytë. Çereku i tretë përfundoi 19:23 dhe ai i fundit 21:17. Kështu trajneri i ri i Golden Eagle Yllit, Fatih Gezer debutoi me fitore prej 91:54. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Samir Zekiqi me 17 pikë, Demetris Morant me 14 pikë e 10 kërcime, Arbër Berisha me 13 pikë e nëntë kërcime, kurse te Trepça, Besnik Azemi dhe Ramadan Zekiqi shënuan nga 15 pikë. Golden Eagle Ylli ka pesë fitore dhe pesë humbje, kurse Trepça dy fitore dhe tetë humbje.

Hasani te Tirana, bëhet lojtari më i paguari në Shqipëri

TIRANË, 23 DHJETOR - Ferhan Hasani është goditja e madhe e Tiranës për merkaton e janarit. Kampionët e Shqipërisë kanë bindur futbollistin e përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut për të firmosur një kontratë 18-mujore me bardheblutë me "Bubën" siç njihet ndryshe Hasani që do të bëhet futbollisti më i paguar i të gjitha kohëve në Kategorinë

Superiore. Në ditët e para të janarit ish-lojtari i Shkëndijës së Tetovës, i cili së fundmi u aktivizua në Finlandë me skuadrën më të mirë të këtij vendi, HJK Helsinki, me të cilën luajti në nëntë takime në kampionat, duke shënuar pesë gola, do të vihet në dispozicion të trajnerit Nevil Dede. Lajmin për "Supersport" e kanë konfirmuar burime pranë klubit të Tiranës

dhe Ferhan Hasani mund të konsiderohet zyrtarisht lojtari më i ri i kampionëve të Shqipërisë. Pas Agim Ibrahimit, një tjetër futbollist me përvojë të pasur ndërkombëtare i cili është aktivizuar edhe në Gjermani me Wolfsburgun dhe në Danimarkë me Brøndbyn vjen në Kategorinë Superiore për ta rritur më shumë nivelin dhe cilësinë e kampionatit tonë.



Messi: Kurrë nuk e kisha menduar që do ta thyjeja rekordin e Peles

BARCELONË, 23 DHJETOR - Leo Messi më në fund arriti ta thyente rekordin e Peles. Me golin e shënuar ndaj Valladolidit arriti në kuotën e 644 me Barcelonën, një më shumë të shënuar me të njëjtën fanellë. "Kur nisa të luaj

futboll nuk mendoja se do të thyjeja rekorde. Aq më pak që të mendoja se do ta thyjeja rekordin e një mbreti si Pele. Dua t'i falënderoj të gjithë që më kanë ndihmuar në këto vite, nga shokët e skuadrës, familja, miqtë

dhe të gjithë ata që më kanë qëndruar pranë. Një përfaqim", ka thënë argjentinas. Pavarësisht se përflitet prej kohësh një largim i mundshëm i 6 herë fituesit të "Topit të Artë", Messi gjithmonë ka dhënë kontributin e tij për ta

ndihmuar Barcelonën. Ndaj Valladolidit shënoi një gol, dha një asistim dhe ishte protagonist edhe në aksionin e golit të dytë. Më shumë nuk mund të bënte në një mbrëmje që me siguri do ta mbajë mend gjatë.



Lakersat e nisin me humbje edicionin e ri në NBA

NJU-JORK, 23 DHJETOR - Kampionati më i ndjekur në glob i basketbollit, NBA, ka ngritur siparin e sezonit të ri në orët e para të mëngjesit të sotëm pikërisht me sfidën e zhvilluar në "Barclays Center" të New Yorkut mes Brooklyn Netsit dhe Golden State Warriorsit. Udhëhequr nga dyshja Kyrie Irving dhe Kevin Durant, Netsi ia doli ta nisë mbarë sezonin, pasi triumfoi me rezultatin 125-99 në një ndeshje në të cilën dominoi që në fraksionin e parë, të cilin e mbylli me shifrat 40-25. Loja e mirë e Brooklynit vijoi edhe në fraksionin e dytë e të tretë, ndërsa Golden State Warriorsit u zgjua vetëm në pjesën e fundit të lojës, por atëherë nuk kishte më kohë për ta shmangur humbjen, pasi gjithçka ishte vendosur më herët.

Vetëm pak pas përfundimit të sfidës në "Barclays Center", zbritën në fushë për ta nisur sezonin e ri edhe kampionët në fuqi, kalifornianët e Los Angeles Lakersit.

Shorti i kishte vendosur këta të fundit në derbin ndaj Los



Angeles Clippersit që në javën e parë, ndërsa në "Staples Center" u zhvillua një sfidë vërtet spektakolare. I udhëhequr nga Paul George dhe Kawhi Leonard, Clippersit i nisi vullshëm fraksionin e parë dhe arriti të fitojë me shifrat 19-39, raporton "ss". Ky rezultat zgjoi Lakersin, që reagoi në fraksionin e dytë dhe fitoi 35-17, por pjesa e tretë

foli sërish për Clippersin që thelloi edhe më tej avantazhin, të cilin e ruajti deri në fund për ta nisur sezonin me fitore. Basketbollisti 30-vjeçar Paul George ishte më i miri i ndeshjes në derbin kalifornian, pasi shënoi 33 pikë, rikuperoi 6 topa dhe dha 3 asistime, duke qenë protagonist i padiskutueshëm i fitores së Los Angeles Clippersit.

Ronaldo: Në fund ne do të festojmë me tifozët

TORINO, 23 DHJETOR - Cristiano Ronaldo ka shprehur optimizëm se Juventusit do t'u rikthehet rezultateve pozitive në vitin 2021. "Bianconerët" i mbyllën ndeshjet e 2020-s me humbje 0-3 në shtëpi nga Fiorentina në Serinë A. Por, ylli portugez beson se skuadra do të rikthehet në rrugën e fitoreve. "Me një paraqitje të zbehtë dhe një rezultat larg nga i pranueshmi, ne i mbyllëm ndeshjet e caktuara për vitin 2020, një vit i veçantë në shumë mënyra. Stadiume bosh, protokolle Covid, ndeshje të anuluar, ndërprerje të mëdha dhe kalendar shumë i ngjeshur. Por, kjo nuk është arsyeja për asgjë", ka thënë Ronaldo. "Ne e dimë se duhet të japim më shumë nga vetja, në mënyrë që të luajmë më mirë dhe të fitojmë më me vazhdimësi. Ne jemi Juventus. Ne, thjesht, nuk mund të pranojmë asgjë më pak se shkëlqim në fushë", ka shtuar Ronaldo. Sulmuesi



beson se "Zonja e Vjetër" do të rikthehet edhe më e fuqishme në vitin 2021. "Shpresoj që kjo ndërprerje e shkurtër do të na ndihmojë të kthehemi edhe më të fortë dhe të bashkuar se kurrë më parë sepse sezoni

është larg nga përfundimi dhe në fund ne besojmë se përsëri do të festojmë me tifozët. Na besoni, besoni tek ekipi siç besojmë ne te ju, dhe do t'ia dalim. Fino alla fine", ka deklaruar Ronaldo.

SHKURT

Berisha mposhti koronavirusin

Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, e ka mposhtur koronavirusin. Kapiteni i kuqezinjve ka rezultuar negativ në tamponët e fundit dhe ka rinisur stërvitjen me skuadrën e Spalit. Ballafaqimi me Covidin nuk ishte i lehtë për portierin shqiptar, i cili u detyrua të shtrihet në spital për trajtim të specializuar.

Menaxheri i Mustafit: Shkodrani në bisedime me Barçën

Qendërmbrojtësi shqiptar Shkodran Mustafi pritet t'i bashkohet Barcelonës në janar, pasi menaxheri i tij Emre Ozturk dhe drejtuesit e gjigantit katalonas janë në bisedime për këtë çështje. Fituesi i Kupës së Botës 2014 me Gjermaninë ende nuk e ka luajtur asnjë ndeshje si titullar nën udhëheqjen e trajnerit Mikel Arteta këtë sezon dhe duket i gatshëm për t'u larguar nga "Emirates". Për më tepër, marrëveshja e Mustafit me Arsenalin mbaron në fund të sezonit. Mësohet se Mustafi e ka hedhur poshtë ofertën e Arsenalit për ta vazhduar marrëveshjen dhe mund t'i bashkohet Barcelonës së Ronald Koeman, e cila është në kërkim urgjent të përforcimeve në mbrojtje. "Nuk jam në Barcelonë për Yusuf Demirin, por për Shkodran Mustafin e Arsenalit, të cilin e përfaqësojmë ne", ka thënë Ozturk.

Del autopsia për vdekjen e Maradonës

Mediat argjentinase kanë zbuluar detaje të autopsisë së trupit të Diego Maradonës para se të ndërronte jetë. Sipas ekspertizës së bërë pas vdekjes, thuhet se Maradona nuk ndërroi jetë menjëherë, por pas 6 deri në 8 orë vuajtjesh. Gjithashtu në organizëm nuk janë gjetur gjurmë alkooli apo edhe drogë, por vetëm ilaçe të ndryshme, duke ditur se vetëm pak kohë më parë ai u bë operacion. Megjithatë, ka ende pretendime se legjendës argjentinase i jepeshin ilaçe, por jo ato për të cilat ai kishte nevojë. Autopsia përcaktoi se Maradona ndërroi jetë nga problemet me mushkëritë dhe zemrën.

Hamiltoni tregon për çastet e vështira që kaloi nga Covidi

Kampioni i botës në Formula 1, Lewis Hamilton, rezultoi pozitiv tri javë më parë në testin e bërë për Covid-19, duke humbur kështu garën e Bahreinit datën e 6 dhjetorit. Mungesën e tij e zëvendësoi piloti i ri George Russell. Edhe pse tashmë është i shëruar plotësisht nga ky virus, anglezi ka deklaruar se kjo sëmundje nuk ishte aspak e lehtë. Në rrjetin social "Instagram", Hamiltoni publikoi një foto ku u shpreh se si pasojë e Covid-19 kishte rënë shumë në peshë. "Kam humbur 6 kg 2 muajt e fundit, 4 ishin si pasojë e Covid-19. Kam humbur shumë masë muskulore. Jam duke u stërvitur me pak forcë. Nuk është argëtuese. Jam i vendosur ta rikthej forcën time prapë dhe do të jem aty ku isha 100%. Pa dhimbje nuk ka fitim", ka thënë Hamiltoni.

Costa në janar largohet nga Atletico

Sulmuesi Diego Costa pritet të largohet nga Atletico Madridi, raportojnë të mërkurën mediet spanjolle. Mësohet se Costa ka refuzuar rinovimin e kontratës që skadon në fund të këtij edicioni pasi po synon të largohet gjatë afatit kalimtar të janarit. Costa nuk është i kënaqur me hapësirën që e ka pasur këtë edicion te Atletico dhe tashmë ua ka bërë me dije drejtuesve të klubit se dëshiron ta vazhdojë karrierën diku tjetër. 32-vjeçari këtë edicion ka vetëm shtatë paraqitje në La Liga dhe ka shënuar dy gola.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzjegjëz të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një veper filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



9 789951 780377

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

[nga Moisiu deri te Kieślowski]



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Kompania Regionale e Mbeturave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regionale e Mbeturave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një (1) Punëtor Fizik -Njësia në Skënderaj - KRM "Uniteti"Sh.A - i Konkursit të shpallur me datë 26.11.2020

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati I konkurimit vazhdohet prej dates **24.12.2020**. deri me date **31.12.2020** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Art Travel" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810862111.

► N.T.P. "Kunevikët" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810536609.

► "Pefaa" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810081638

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Nesër më 24.12. 2020 behën 16 vjet pa më të dashurin tonë



Liridon (Sejdi) Dërmaku

(17.07.1983 - 24.12.2004)

Bir, vëlla e axhë kaluan 16 vjet që kur të vrau armiku, i cili ishte dhe është kundër bashkimit kombëtar. Ti pusho i qet në dheun e Shqiptarisë, sepse Shqipëria po bëhet e do të bëhet ashtu siç ti dhe luftëtarët e lirisë e latë amanet. Në çdo përvjetor tëndin na pyesin, nëse po mërzitemi e po kemi mall për ty. Është e pamposhtur dhembja dhe i padurueshëm malli për ty, por krenaria që dhe jetën për jetët e shqiptarëve dhe Shqiptarisë na jep forcë që të vazhdojmë përpara. Ti je atje ku gjenden më të mirët e kombit, duke i bërë roje atdheut. Nderime Atdheut dhe lavdi ty dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë dhe bashkimin e shqiptarëve. Gjithmonë krenarë me ty!

Të kujtojnë dhe kurrë s'të harrojnë: Nëna Feridja, babai Sejdiu dhe e tërë familja Dërmaku nga Shipashnica e Epërme e Dardanës dhe Prishtina.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

